



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Kaçanik
Opština Kacanik
Municipal off Kacanik
-KUVENDI I KOMUNËS-

01Nr. 350-2209/14
Kaçanik, 31.01.2014

Në bazë të nenit 4 paragrafi 2 pika: 2, 3, 4,dhe 6 e Ligjit nr. 03/L-139-Për shpronësimimin e pronës së paluajtshme, të nenit 17 të Ligjit nr. 03/L-040 -Për Vetëqeverisje Lokale, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur më datë, 31.01.2014, mori këtë:

V E N D I M
MBI VËRTETIMIN E INTERESIT TË PËRGJITHSHËM PËR ZGJËRIMIN
E FUSHËS SË FUTBOLLIT DHE FUSHËS NDIHMËSE

I.

VËRTETOHET se zgjërimi - rregullimi i fushës së futbollit dhe asaj ndihmëse "Besnik Begunca", është në interes të përgjithshëm publik dhe lidhur me të mund të fillojnë procedurat e shpronësimit.

Patundshmëria në të cilën duhet të rregullohet fusha e futbollit, përbëhet nga pjesa e parcelës kadastrale nr. 00230-0, me kulturë livadh i kl. 4, me sipërfaqe prej 72m2, në emër të Milaim Ramadan Zeneli nga f. Bob, Z.K Bob, dhe pjesa e parcelës kadastrale nr. 00231-0, me kulturë maden rërë me sipërfaqe prej 50 m2, në emë emër të Mefail Faik Zeneli nga f. Bob, Z. K. Bob.

II.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit.

III.

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e marrjes.

Me këtë Vendim njoftohen:

1. Kryetari i Komunës,
2. Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit,
3. Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim,
4. Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës, dhe
5. Arkiva.



Kryesuesi i Kuvendit,
Xhelal Gashi